



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3247/ 13 prot.,

Datë 04.02.2026

V E N D I M
Nr. 208/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 144/2026, datë 27.01.2026 për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-63273-10-01-2025, me objekt “Asaltim i rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnje” me fond limit: 49,997,122 (dyzetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike.
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Pasurisë Publike.
Adresë: Lagjja: “Gafurr Muco”, Lushnje
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Biba X” SHPK me NIPT K32618815N, me adresë: Fshati Kryeluzaj, Pika Inerte 50 m pranë Karburant “Eurodrin”, Kavajë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 27.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 144/2026, ku vendosi:

[.....]

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Biba X” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-63273-10-01-2025, me objekt “Asaltim i rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnje” me fond limit: 49,997,122 (dyzetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Biba X” SHPK, dhe të rivlerësojë ofertën e këtij operatori ekonomik duke e kualifikuar atë.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biba X” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik..*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë...” [...]

I.2. Me shkresën nr. 170 prot., datë 29.01.2026, protokolluar me tonën nr. 3247/10 prot., datë 02.02.2026, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Lushnje, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1449/2026 datë 27.01.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 170 prot., datë 29.01.2026, protokolluar me tonën nr. 3247/10 prot., datë 02.02.2026, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Lushnje, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1449/2026 datë 27.01.2026.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke kualifikuar operatorin ekonomik “Biba X” SHPK në përputhje me vendimin e KPP Nr. 144/2026, datë 27.01.2026.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-63273-10-01-2025, me objekt “*Asaltim i rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnje*” me fond limit: 49,997,122 (*dyzetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzetë e dy*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

